



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 14.03.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-4634-15, për Zyrtarin e lartë, z.Milot Mustafa-Anëtar i Këshillit Drejtues në Ansamblin “Shota”, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-4634-15, për Zyrtarin e lartë, z.Milot Mustafa-Anëtar i Këshillit Drejtues të Ansamblit “Shota”, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Mustafa është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (Akk-03-02 DPK-01-660/16), pas të cilës ai është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç’rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Mustafa është deklaruar se brenda afatit do t’i bëjë ndryshimet e nevojshme në biznes për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka dërguar informatat mbi biznesin konsulent N.Sh.“Art Miron”(DPK/DPKI-03-02-1046/16), të lëshuara nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), në të cilat shihet se, z.Mustafa tashmë ka hequr dorë nga e drejta e të qenurit person i autorizuar i biznesit privat, me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit



/ Hasan Preteni